Vendim nr. 295, datë 18.09.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, anëtarë, në datën 18.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (Sh) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE:	**SHOQATA ASOCIACIONI KOMBËTAR I MEDIAS DHE DREJTËSISË,** përfaqësuar nga kryetari Gjergji Zefi.
OBJEKTI:	**Shfuqizimi i pikës 6 të nenit 166 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.** **Pezullimi i zbatimit të kësaj dispozite (marrja e masës së sigurimit) deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.** **Deklarimi si i paligjshëm i çdo akti administrativ të nxjerrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që bazohet mbi këtë dispozitë antikushtetuese për emërimin e anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në sistemin gjyqësor.**
BAZA LIGJORE:	**Nenet 42, 124, 131, pika 1, shkronja "a", 132 dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese *(Mbledhja e Gjyqtarëve)*, pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) ka miratuar ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, sipas të cilave, ndër të tjera, parashikohej ngritja e një sistemi rivlerësimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili do të kryhej nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet ndaj vendimeve të këtij të fundit do të shqyrtoheshin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese (*KPA*). Po kështu, mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelimit do të ishte 9 vjet (neni 179/b i Kushtetutës).

2. Në zbatim të këtyre parashikimeve kushtetuese, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 96/2016*), si pjesë të paketës të ligjeve të reformës në drejtësi. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: a) të drejtat dhe detyrimet e tyre; b) pranimin dhe emërimin e tyre; c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre; d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre. Po sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit.

3. Ndër të tjera, në dispozitat kalimtare për ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët, konkretisht neni 166, pika 6, ky ligj ka parashikuar se "*anëtari i Kolegjit të Apelit emërohet si gjyqtar në nivel apeli në përfundim të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tij është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës*". Rezulton se në datën 17.06.2026 ka përfunduar mandati i *KPA*-së.

4. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 05.05.2026 me kërkesë sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 19.05.2026. Në datën 28.07.2026 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkueses

5. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se dispozita e kundërshtuar ka cenuar:

5.1. *Parimin e meritokracisë dhe karrierës,* të parashikuar në nenin 135 të Kushtetutës, pasi dispozita objekt kundërshtimi emëron gjyqtarët e KPA-së në gjykatën e apelit pa plotësuar kërkesën e karrierës, konkretisht përvojën 7 vjet si gjyqtar i shkallës së parë. Anëtarët e KPA-së nuk i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit sipas 3 shtyllave (pasuria, figura, aftësia) siç e kërkon Kushtetuta, ndërkohë kjo dispozitë u jep atyre një "imunitet" të pajustifikuar. Gjithashtu, ata nuk gëzojnë statusin "magjistrat", pasi vijnë nga radhët e juristëve/avokatëve dhe jo nga Shkolla e Magjistraturës. Në këtë kuptim edhe kërkesa e anëtarëve të KPA-së drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të trajtohet si e paligjshme, pasi sistemi i gjykatës së apelit është sistem karriere, ata nuk kanë ushtruar funksionin për 9 vjet dhe nuk kanë kaluar procesin e rivlerësimit. Kjo e kthen KLGJ-në në një organ noterial dhe paraqitet si njoftim paraprak për një fakt të pranuar, duke kërkuar një sistem privilegjesh.

5.2. *Parimin e shtetit të së drejtës,* të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi, nga njëra anë, Kushtetuta dhe ligjet organike i trajtojnë anëtarët e KPA-së si subjekte me status të posaçëm, ndërsa, nga ana tjetër, një dispozitë e vetme ligjore përpiqet t'i rikthejë ata në sistem si magjistratë të zakonshëm, pa konkurrim, pa procedurë dhe pa kaluar filtrat që vlejnë për të gjithë. Në këtë mënyrë, kjo dispozitë bie ndesh me vetë filozofinë mbi të cilën u ndërtua reforma në drejtësi, si edhe me mënyrën sesi vetë ligji përcakton sesi hyn në sistemin gjyqësor dhe ngrihet në detyrë një magjistrat. Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar se hyrja dhe rikthimi në sistem nuk bëhen automatikisht, por vetëm pas filtrave, verifikimit dhe procedurës. Neni 166, pika 6, i ligjit nr. 96/2016 është një normë e paharmonizuar me strukturën e ligjit, e vendosur aty jo si rezultat i një logjike juridike dhe që përbën një cenim të standardit moral. Anëtarët e KPA-së pretendojnë se gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës, por kërkojnë një privilegj që vetë gjyqtarët kushtetues nuk e kanë. Ata kërkojnë të hyjnë në sistem jo duke kaluar nëpër të njëjtat procedura, filtra dhe konkurse që u kërkuan subjekteve të rivlerësimit, por duke kërkuar një rrugë të posaçme, një vend të rezervuar dhe një përjashtim nga rregullat. Po kështu, ata nuk kalojnë as filtrin e figurës, ndonëse mund të kenë pasur kontakte që konsiderohen "të papërshtatshme". Nëse KLGJ-ja emëron anëtarët e KPA-së në apel, çdo vendim që ata do të japin në të ardhmen do të rrëzohet nga GJEDNJ-ja, sepse trupa gjykuese do të konsiderohet e

paligjshme. Gjithashtu, emërimi automatik cenon besimin e publikut. KLGJ-ja duhet të mbajë në konsideratë dispozitat kushtetuese të cilat mbrojnë në mënyrë të veçantë zhvillimin e karrierës së gjyqtarit. Fakti i ruajtjes së garancisë statutore, pra të emërimit përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, u bë për shkak të eliminimit të korrupsionit në sistemin e drejtësisë.

5.3. *Parimin e sigurisë juridike,* pasi qytetarët që i drejtohen gjykatës së apelit kanë "pritshmërinë legjitime" që çështja e tyre do të shqyrtohet nga një magjistrat i certifikuar, i cili ka kaluar filtrat e vetingut (pasuri, figurë, aftësi) siç e kërkon Kushtetuta. Emërimi i anëtarëve të KPA-së pa këto filtra krijon një gjendje pasigurie, pasi qytetari nuk ka garanci nëse gjyqtari i tij plotëson kriteret e integritetit dhe pastërtisë dhe çdo vendim i dhënë do të jetë i ankimueshëm në çdo kohë përmes kërkesës për rishikim ose ankimimit në GJEDNJ.

5.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit,* të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi dispozita krijon diskriminim pozitiv të pajustifikuar, sepse ish-gjyqtarët duhet të kenë 9 vjet përvojë dhe t'i nënshtrohen vlerësimit etik/profesional për t'u riemëruar, ndërsa anëtarët e KPA-së emërohen automatikisht. Kështu cenohet edhe pavarësia, edhe profesionalizmi i sistemit gjyqësor, pasi lejon emërimin në nivele të larta të gjyqësorit (apel) të personave që nuk kanë kaluar filtrat e vetingut dhe nuk gëzojnë statusin e magjistratit sipas kritereve të barabarta për të gjithë. Emërimi automatik i tyre në sistem krijon një standard të dyfishtë.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

6. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 43, datë 24.07.2025; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

7. Në kuptim të rregullimeve të parashikuara nga neni 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës dhe neni 49, pika 3, shkronja "d", të Ligjit Organik të Gjykatës, në jurisprudencën e

saj Gjykata ka theksuar se organizatat kanë të drejtën për të filluar një kontroll për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre, si dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre. Po kështu, bazuar në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, organizatat duhet të provojnë se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre *(shih vendimet nr. 3, datë 30.01.2024; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

8. Sipas Gjykatës, në çështje të kontrollit kushtetues të normës organizata duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe normës që kundërshton. Vetëm fakti se akti i kundërshtuar mund të ketë ose ka pasur një efekt çfarëdo për kërkuesen, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ajo legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut. Vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka ose jo mjaftueshëm interes për vënien në lëvizje të saj për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë *(shih vendimet nr. 3, datë 30.01.2024; nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 20, datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

9. Në rastin konkret Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja është person juridik i regjistruar me vendimin nr. 7685, datë 28.01.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sipas statutit, shoqata është themeluar si një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare dhe jopolitike, me anëtarësi, që ka për objekt mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së shprehjes, të drejtave të medias dhe drejtësisë, si dhe sigurimin e një sistemi drejtësie të pavarur dhe të paanshëm, monitorimin e situatës së medias dhe sistemit të drejtësisë, duke mbikëqyrur funksionin e tyre, organizimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe edukative, bashkëpunimin me institucione dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështetjen juridike dhe ligjore për gazetarët dhe aktorët e drejtësisë në nevojë, zbulimin dhe denoncimin e shkeljeve të lirisë së shprehjes, të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë së pavarur, hartimin dhe publikimin e raporteve analitike dhe opinioneve juridike, krijimin e platformave për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe gazetarëve investigativë, organizimin e trajnimeve për gazetarët dhe profesionistët e drejtësisë, zhvillimin e projekteve që nxisin transparencën institucionale dhe përgjegjshmërinë e pushtetit, mbështetjen e nismave ligjore për përmirësimin e legjislacionit në fushën e medias dhe drejtësisë,

krijimin e një rrjeti solidariteti për mbrojtjen e profesionistëve të medias dhe drejtësisë etj. (neni 6 i statutit).

10. Ndërsa referuar aktit të themelimit (neni 4) objekti kryesor i shoqatës është promovimi i lirisë së shprehjes dhe mbrojtja e të drejtave të mediave dhe drejtësisë dhe një nga qëllimet kryesore është të kontribuojë në krijimin e një hapësire të lirë dhe të sigurt për shprehjen e mendimeve dhe ideve, të angazhohet për të lobuar për ndryshime ligjore që mbrojnë lirinë e shprehjes dhe medias, duke siguruar që ligjet në fuqi të mos kufizojnë këtë të drejtë në mënyrë të padrejtë dhe të kundërligjshme, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të mediave dhe drejtësisë, si dhe të sigurisë ligjore për gazetarët dhe profesionistët e medias. Shoqata, gjithashtu, angazhohet për reforma që sigurojnë një sistem gjyqësor të pavarur dhe të drejtë, ku liria e medias dhe të drejtat e gazetarëve janë të mbrojtura, për forcimin e mbrojtjes ligjore për ata që ushtrojnë profesione në fushën e medias dhe të drejtësisë, në luftën kundër censurës dhe abuzimeve që vijnë nga autoritetet shtetërore, politikanët ose grupe të tjera me pushtet, që mund të përpiqen të kufizojnë lirinë e medias dhe të ndikojnë në mënyrën sesi raportohet informacioni, ndryshime ligjore dhe politike që mbrojnë të drejtat e medias dhe të drejtësisë, duke kontribuar në një mjedis të qëndrueshëm dhe të drejtë për lirinë e shprehjes, ndërmarrjen e nismave për të kundërshtuar çdo formë censurimi të mediave, mbrojtjen e të drejtave të medias në të gjitha format e saj, duke siguruar që ato të funksionojnë pa ndërhyrje nga autoritetet shtetërore, politikanët ose grupe të interesit. Po kështu, ajo ka qëllim mbrojtjen e sistemit të drejtësisë dhe sigurinë e përmbushjes së standardeve të larta të drejtësisë, në mënyrë që të sigurohet që çdo individ të ketë mundësi për të kërkuar drejtësi në mënyrë të barabartë dhe të paanshme dhe do të angazhohet aktivisht për lobimin dhe për krijimin e reformave ligjore që synojnë mbrojtjen e të drejtave të medias, përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët dhe forcimin e sistemit të drejtësisë dhe avokatisë në monitorimin e vazhdueshëm të situatës së medias dhe sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke mbajtur një vështrim të përditshëm mbi zhvillimet ligjore, politike dhe shoqërore që ndikojnë në këto dy fusha etj.

11. Në lidhje me kriterin e legjitimimit *ratione personae,* Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja ka pretenduar se legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi qëllimi i saj është mbrojtja e interesave të gazetarëve dhe avokatëve, mbrojtja e interesit publik, si dhe garantimi i të drejtave dhe interesave të qytetarëve, duke promovuar transparencën, drejtësinë, pavarësinë e medias dhe sistemit ligjor, trajtimin jo diskriminues të avokatëve dhe monitorimin e sistemit të drejtësisë.

12. Nisur nga sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se objekti i veprimtarisë së kërkueses përfshin, krahas mbrojtjes dhe promovimit të lirisë së shprehjes dhe të drejtave të medias, edhe çështje që lidhen me drejtësinë, pavarësinë e sistemit gjyqësor, monitorimin e

funksionimit të tij, transparencën institucionale dhe nxitjen e reformave ligjore në këtë fushë. Pra, në këtë këndvështrim, veprimtaria e saj në terma të përgjithshëm ka lidhje edhe me fushën e drejtësisë. Pavarësisht kësaj, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme, në vetvete, për ta legjitimuar kërkuesen për kundërshtimin e çdo norme që rregullon organizimin, funksionimin ose statusin e subjekteve të sistemit të drejtësisë, pasi ajo duhet të tregojë ekzistencën e një lidhjeje të mjaftueshme ndërmjet dispozitës konkrete të kundërshtuar dhe interesit që synon të mbrojë sipas qëllimit dhe veprimtarisë së saj.

13. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se norma e kundërshtuar, neni 166, pika 6, i ligjit nr. 96/2016, rregullon statusin profesional të anëtarëve të KPA-së pas përfundimit të mandatit të tyre, duke përcaktuar kushtet për emërimin e tyre si gjyqtarë në nivel apeli, por nuk krijon të drejta, detyrime ose kufizime për kërkuesen. Po kështu, nuk rezulton që kërkuesja të përfaqësojë anëtarët e KPA-së, gjyqtarët ose kandidatët për gjyqtarë të nivelit të apelit, në mënyrë që nga zbatimi i dispozitës të kundërshtuar të evidentohet cenimi i një interesi kolektiv konkret të përfaqësuar prej saj. Në këtë këndvështrim, kërkuesja nuk ka evidentuar ndonjë pasojë konkrete ose potenciale të normës së kundërshtuar mbi veprimtarinë e saj, të tillë si pengimi i monitorimit të sistemit të drejtësisë, kufizimi i veprimtarisë së saj, cenimi i të drejtave ose interesave të anëtarëve të saj apo të ndonjë interesi tjetër që ajo mbron sipas statutit dhe aktit të themelimit.

14. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se pretendimet e kërkueses për meritokracinë, statusin e magjistratit, karrierën gjyqësore, procesin e rivlerësimit dhe barazinë e kandidatëve lidhen me mënyrën e rregullimit të statusit dhe karrierës së një kategorie të caktuar funksionarësh të sistemit të drejtësisë dhe, për rrjedhojë, kanë në thelb karakter objektiv dhe institucional. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kundërshtimi i normës nga kërkuesja synon, në thelb, ushtrimin e kontrollit kushtetues të rregullimit ligjor me parimet kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor, duke mos evidentuar një lidhje konkrete me interesat që ajo përfaqëson ose synon të mbrojë.

15. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se përfshirja në objektin e veprimtarisë së kërkueses të çështjeve që lidhen me drejtësinë, pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe reformat ligjore në këtë fushë nuk mjafton për të provuar interesin e saj për kundërshtimin e dispozitës objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues të kësaj dispozite.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.

17. Ligji nr. 96/2016 është miratuar në datën 06.10.2016, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 208, datë 07.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se, pavarësisht ndryshimeve të mëvonshme të këtij ligji, neni 166, pika 6, objekt kundërshtimi, nuk ka pësuar ndryshime. Ndërkohë, kërkesa është paraqitur në datën 05.05.2026 dhe është regjistruar në Gjykatë në datën 19.05.2026. Kërkuesja ka parashtruar se i është drejtuar Gjykatës në momentin kur KPA-ja i është drejtuar KLGJ-së për zbatimin e nenit 166, pika 6, të ligjit nr. 96/2016.

18. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se afati 2-vjeçar i përcaktuar nga neni 50, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës lidhet shprehimisht me hyrjen në fuqi të aktit të kundërshtuar dhe, për rrjedhojë, fillimi i tij nuk kushtëzohet nga momenti kur norma gjen zbatim në një rast konkret, në ndryshim nga ankimi kushtetues individual, për të cilin neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës e lidh afatin me konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese. Për rrjedhojë, fakti i pretenduar nga kërkuesja se KPA-ja i është drejtuar KLGJ-së për zbatimin e dispozitës së kundërshtuar nuk mund të përcaktojë një moment të ri të fillimit të afatit për kundërshtimin e saj. Duke qenë se neni 166, pika 6, nuk ka pësuar ndryshime që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, ndërsa kërkesa është paraqitur pas përfundimit të afatit 2-vjeçar të parashikuar nga ligji, ajo nuk plotëson kriterin e legjitimimit *ratione temporis*.

19. Në kushtet kur kriteret e legjitimimit janë kumulative dhe kërkuesja nuk plotëson kriteret *ratione personae* dhe *ratione temporis*, nuk mund të vijohet me shqyrtimin e mëtejshëm të kriterit *ratione materiae*.

20. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat "b" dhe "ç", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin paraprak të kërkesës së paraqitur nga Shoqata Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë, për kundërshtimin e nenit 166, pika 6, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 96/2016*), bashkohem me përfundimin e shumicës për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të paraqitjes së kërkesës jashtë afatit ligjor dhe, për rrjedhojë, të moslegjitimimit të kërkueses *ratione temporis*. Megjithatë, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket legjitimimit *ratione personae*, pasi vlerësoj se kërkuesja justifikon interesin e saj për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues dhe, për këtë arsye, e përmbush këtë kriter, bazuar në argumentet e mëposhtme.

2. Në datën 05.05.2026 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e nenit 166, pika 6, të ligjit nr. 96/2016, që parashikon emërimin e anëtarëve të KPA-së si gjyqtarë në nivel apeli pas përfundimit të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tyre është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës. Sipas kërkueses, kjo dispozitë cenon parimet kushtetuese të meritokracisë, statusit të magjistratit, karrierës gjyqësore, procesit të rivlerësimit dhe barazisë së kandidatëve. Për të mbështetur legjitimimin e saj, ajo u është referuar qëllimeve statutore, që përfshijnë mbrojtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë, monitorimin e funksionimit të tij dhe nxitjen e reformave ligjore.

3. Shumica ka vlerësuar se përfshirja e çështjeve të drejtësisë në objektin e veprimtarisë së kërkueses nuk mjafton për të justifikuar interesin e saj për kundërshtimin e dispozitës konkrete. Sipas shumicës, norma rregullon statusin profesional të anëtarëve të KPA-së, pa krijuar të drejta ose detyrime për kërkuesen, e cila nuk përfaqëson subjektet e prekura prej saj dhe nuk ka evidentuar pasoja konkrete ose potenciale mbi veprimtarinë ose interesat që mbron. Po kështu, pretendimet e ngritura kanë karakter objektiv dhe institucional, pa dëshmuar një lidhje konkrete me interesat e kërkueses. Për rrjedhojë, shumica ka arritur në përfundimin se ajo nuk legjitimohet *ratione personae* (*shih paragrafët 12–15 të vendimit*).

4. Në vlerësimin tim, ky qëndrim mbështetet në një interpretim të ngushtë të interesit të organizatave për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues të normës. Neni 49, pika 3, shkronja

“d”, i Ligjit Organik të Gjykatës u njeh organizatave të drejtën për të kërkuar këtë kontroll kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat e liritë e anëtarëve të tyre. Kjo dispozitë duhet interpretuar në lidhje me pikën 4 të të njëjtit nen, sipas së cilës organizatat duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë të çështjes me të drejtat dhe liritë kushtetuese ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre. Për rrjedhojë, në ndryshim nga sa analizon shumica, lidhja me qëllimet statutore përbën një kriter të mëvetësishëm për vlerësimin e legjitimimit, i cili nuk kushtëzohet domosdoshmërisht nga cenimi i të drejtave të anëtarëve të organizatës ose nga përfaqësimi i subjekteve të cilave u drejtohet norma e kundërshtuar.

5. Në këtë kuptim, vlerësimi i interesit të organizatës për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues nuk duhet të ngushtohet vetëm në ekzistencën e pengesave ose kufizimeve të dukshme që norma e kundërshtuar mund t’i sjellë ushtrimit të aktiviteteve të saj konkrete, si monitorimi, publikimi i raporteve ose organizimi i fushatave ndërgjegjësuese. Interesi kushtetues që organizata gëzon për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues duhet analizuar bazuar në natyrën e veprimtarisë që ushtron dhe në qëllimet për të cilat është themeluar, sipas statutit të saj. Për rrjedhojë, mungesa e pengesave të drejtpërdrejta në ushtrimin e aktiviteteve të organizatës nuk përjashton legjitimimin e saj për të kundërshtuar një normë që rregullon çështje të lidhura drejtpërdrejt me interesat dhe qëllimet statutore që ajo synon të mbrojë.

6. Në këtë pikë, duhet konsideruar edhe roli i organizatave të shoqërisë civile në një shtet demokratik. Përmes monitorimit të ushtrimit të pushtetit publik, evidentimit të problematikave dhe nxitjes së përmirësimeve ligjore, këto organizata kontribuojnë në transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave që përfaqësojnë. Ushtrimi i këtij roli mbikëqyrës përfshin edhe mundësinë për t’iu drejtuar Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së normave që lidhen drejtpërdrejt me misionin e tyre. Kushtëzimi i kësaj mundësie vetëm nga ekzistenca e kufizimeve mbi aktivitetet e organizatës ose nga përfaqësimi i subjekteve të cilave norma u drejtohet do ta ngushtonte në mënyrë të pajustifikuar këtë rol.

7. Duke iu kthyer rastit konkret, nga statuti i kërkueses rezulton se qëllimet e saj përfshijnë sigurimin e një sistemi drejtësie të pavarur dhe të paanshëm, monitorimin e funksionimit të tij, mbështetjen e nismave ligjore për përmirësimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, si dhe hartimin e raporteve analitike dhe opinioneve juridike. Këto qëllime shprehin një angazhim të përcaktuar për mbrojtjen e standardeve të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor, të cilat kanë rëndësi kyçe për të drejtën themelore të procesit të rregullt ligjor. Ndërkohë, dispozita e kundërshtuar rregullon emërimin e anëtarëve të KPA-së si gjyqtarë në nivel apeli pas përfundimit

të mandatit të tyre, pra një çështje që lidhet drejtpërdrejt me mënyrën e përfshirjes në trupën gjyqësore dhe me kushtet e fitimit të këtij funksioni.

8. Në këtë kontekst, pretendimet e kërkueses për meritokracinë, statusin e magjistratit, karrierën gjyqësore dhe barazinë e kandidatëve e konkretizojnë lidhjen ndërmjet normës së kundërshtuar dhe qëllimeve të veprimtarisë së saj. Fakti se këto pretendime kanë karakter institucional nuk e përjashton këtë lidhje, për sa kohë mbrojtja e standardeve të sistemit të drejtësisë përbën pjesë të misionit statutor të kërkueses. Po kështu, fakti se ajo nuk përfaqëson anëtarët e KPA-së ose kandidatët për gjyqtarë të apelit nuk është përcaktues, pasi interesi i saj në këtë çështje buron nga veprimtaria për monitorimin dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Njohja e këtij interesi nuk nënkupton pranimin e pretendimeve për antikushtetutshmërinë e dispozitës, të cilat i përkasin shqyrtimit të themelit të çështjes.

9. Për sa më lart, vlerësoj se, në rrethanat e rastit konkret, kërkuesja ka justifikuar një lidhje të mjaftueshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar ndërmjet qëllimeve të veprimtarisë së saj dhe çështjes kushtetuese të ngritur, ndaj legjitimohet *ratione personae*. Ky përfundim mbështetet në përputhjen konkrete ndërmjet marrëdhënies së rregulluar nga dispozita e kundërshtuar dhe qëllimeve statutore të kërkueses dhe nuk i njeh asaj një të drejtë të përgjithshme për të kundërshtuar çdo normë që lidhet me sistemin e drejtësisë.

10. Megjithatë, në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bashkohem me arsyetimin dhe përfundimin e shumicës. Afati 2-vjeçar i parashikuar nga neni 50, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës lidhet me hyrjen në fuqi të aktit të kundërshtuar. Neni 166, pika 6, i ligjit nr. 96/2016 nuk ka pësuar ndryshime që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa kërkesa është paraqitur në datën 05.05.2026, pas përfundimit të afatit ligjor. Momenti kur është kërkuar zbatimi konkret i dispozitës nuk përcakton një moment të ri të fillimit të këtij afati.

11. Në përfundim, duke qenë se kriteret e legjitimimit janë kumulative, çmoj se kërkesa nuk duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare vetëm për shkak të mosplotësimit të kriterit të legjitimimit *ratione temporis*.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Shoqata "*Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë*" me objekt shfuqizimin e pikës 6 të nenit 166 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pezullimin e zbatimit të kësaj dispozite (marrja e masës së sigurimit) deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese dhe deklarimin si të paligjshëm të çdo akti administrativ të nxjerrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që bazohet mbi këtë dispozitë antikushtetuese për emërimin e anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në sistemin gjyqësor, ne gjyqtarët Marjana Semini dhe Asim Vokshi jemi kundër vendimit të shumicës për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe në vijim parashtrojmë argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Në vlerësimin tonë rasti kushtetues objekt gjykimi ngre çështje mjaft të rëndësishme me natyrë kushtetuese, të cilat lidhen drejtpërdrejt me konceptin e gjykatës "*së caktuar me ligj*", si një prej koncepteve kryesore kushtetuese që mishërohen në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata e caktuar me ligj është jetike për respektimin e parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, në rendin kushtetues shqiptar. Kërkuesja ka objekt të veprimtarisë së saj si shoqatë, ndër të tjera, edhe "*mbrojtjen e sistemit të drejtësisë*", "*forcimin e mbrojtjes ligjore*", "*kërkimin e një drejtësie të barabartë dhe të paanshme*", etj (*shih vendimin e Gjykatës, paragrafët 9-10*).

3. Shumica shprehet se "*Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se norma e kundërshtuar, neni 166, pika 6, i ligjit nr. 96/2016, rregullon statusin profesional të anëtarëve të KPA-së pas përfundimit të mandatit të tyre, duke përcaktuar kushtet për emërimin e tyre si gjyqtarë në nivel apeli, por nuk krijon të drejta, detyrime ose kufizime për kërkuesen. Po kështu, nuk rezulton që kërkuesja të përfaqësojë anëtarët e KPA-së, gjyqtarët ose kandidatët për gjyqtarë të nivelit të apelit, në mënyrë që nga zbatimi i dispozitës të kundërshtuar të evidentohet cenimi i një interesi kolektiv konkret të përfaqësuar prej saj. Në këtë këndvështrim, kërkuesja nuk ka evidentuar ndonjë pasojë konkrete ose potenciale të normës së kundërshtuar mbi veprimtarinë e saj, të tillë si pengimi i monitorimit të sistemit të drejtësisë, kufizimi i veprimtarisë së saj, cenimi i të drejtave ose interesave të anëtarëve të saj apo të ndonjë interesi tjetër që ajo mbron sipas statutit dhe aktit të themelimit.*". Në fakt ne vlerësojmë se vlen krejt e kundërta në këtë rast. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë, që synon potencialisht të parandalojë cenimin e parimit të "*gjykatës së caktuar me ligj*", si një e drejtë themelore e kujtdo, përfshirë dhe kërkuesin. Argumentet e kërkueses, edhe sikur të mos ishin të mbështetura në themel në dispozitat kushtetuese, meritojnë

trajtimin në substancë nga Gjykata. Nuk ka kuptim të kërkohet ardhja e pasojave konkrete kur kundërshtohet në mënyrë abstrakte neni 166, pika 6, i ligjit nr. 96/2016, pasi nëse qëndrojnë pretendimet e kërkuesit, dëmi është evident për këdo që merr shërbime gjyqësore, pasi do të gjykohet nga gjyqtarë të pacaktuar sipas parashikimeve kushtetuese, pikërisht për shkak se norma e kundërshtuar, bie ndesh me dispozitat kushtetuese e veçanërisht me nenin 136/a, pika 1, të Kushtetutës.

4. Për sa më sipër, vlerësojmë se ishte e domosdoshme që Gjykata ta trajtonte në themel këtë çështje dhe të legjitimonte *ratione personae* kërkuesen, pikërisht për shkak të interesit të lartë kushtetues që mbart çështja e paraqitur për gjykim dhe pasojave eventuale të rënda që mund t'u vijnë individëve nga gjykimi i çështjeve të tyre, prej gjyqtarëve të caktuar në detyrë në shkelje të Kushtetutës. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese duhet të krijojë të gjitha mundësitë që organizatat jofitimprurëse të gëzojnë akses sa më të plotë për trajtimin e çështjeve që lidhen me sistemin e drejtësisë të pavarur dhe të paanshme dhe respektimin e parimit të shtetit ligjor, qoftë edhe në rastin kur në statutin e tyre parashikojnë në mënyrë të përgjithshme këtë qëllim të lidhur me mbrojtjen dhe forcimin e sistemit të drejtësisë.

5. Po ashtu, vlerësojmë se duhej konsideruar nga Gjykata se kërkuesja e plotësonte edhe kriterin *ratione temporis*, pasi neni 50, pika 4 i Ligjit Organik të Gjykatës ka vendosur shprehimisht afatin 4 mujor për individët, që fillon të ecë nga momenti i "konstatimit të cenimit" prej tyre. Në rastin konkret, kërkuesja ka argumentuar bindshëm se i është drejtuar Gjykatës në momentin që ka marrë dijeni për faktin se KPA-ja i ishte drejtuar KLGJ-së për zbatimin e nenit 166, pika 6, të ligjit nr. 96/2016, duke qenë kësisoj brenda afatit të parashikuar në Ligjin Organik. Lidhur me këtë çështje ne gjyqtarët e pakicës vlerësojmë se kërkuesja si individ legjitimohet "*ratione temporis*", sepse në kërkesën e saj është argumentuar bindshëm edhe lidhur me momentin kohor kur ka marrë dijeni për fillimin e ardhjes së pasojave juridike nga zbatimi i dispozitës ligjore objekt i këtij gjykimi kushtetues, pra momentin kur parimi kushtetues i gjykatës "*së caktuar me ligj*" dhe dispozitat kushtetuese relevante janë cenuar në mënyrë konkrete, sipas kërkueses duke shkelur drejtpërdrejt qasjen e tij në një gjykatë të formuar sipas normave kushtetuese, pa pasur nevojë që të vijnë pasoja të tjera në shkelje të nenit 18 të Kushtetutës.

6. Prandaj, jemi të mendimit se çështja paraqiste interes të lartë publik dhe duhej trajtuar nga Gjykata, me qëllim që ajo të merrte njëherë e mirë përgjigje kushtetuese nga i vetmi forum që ka tagrin kushtetues të thotë fjalën e fundit për këtë çështje, që është Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë.

Anëtarë: Marjana Semini, Asim Vokshi